

NE EMER TE POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosoves ne kolegjin e perbere nga Gjyqtari i EULEX-it Norbert Koster si Kryetar i Kolegjit, Gjyqtari i EULEX-it Martti Harsia, si dhe gjyqtaret e Gjykates Supreme Marije Ademi, Nesrine Lushta dhe Salih Toplica si anetare te kolegjit, te ndihmuar nga Zyrtari ligjor i EULEX-it Holger Engelmann, ne cilesine e procesmbajtesit,

Ne lenden penale kunder te akuzuarit E. H. te birit te .
, komuna , ndihmes mirembajtes i shkolles, i veje, me gjendje te mesme ekonomike, nuk eshte i denuar me pare, i akuzuar per vepren penale te Vrasjes se rende ne kundershtim me Nenin 147, piken 9 te Kodit te Perkohshem Penal te Kosoves (tash e tutje: KPPK) dhe per vepren penale Mbajtje ne pronesi, ne kontroll, ne posedim ose ne shfrytezim te paautorizuar te armeve ne kundershtim me Nenin 328, par. 2 i KPPK-se, i mbajtur ne paraburgim qe nga data 31 maj 2007,

Duke vendosur mbi ankesen e paraqitur me 28 prill 2010 nga Avokati mbrojtës R. K. ne emer te te pandehurit E. H. kunder Aktgjykimit P. Nr. 215/2007, te leshuar nga Gjykata e Qarkut te Mitrovice me daten 16 shkurt 2010,

Ne seancen e mbajtur me 5 tetor 2010, pas keshillimit dhe votimit leshon kete

AKTGJYKIM

Ankesa nga Avokati mbrojtës R. K. ne emer te te pandehurit E. H. refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi i shkalles se pare i Gjykates se qarkut ne Mitrovice, P. Nr. 215/2007, i dates 16 shkurt 2010, vertetohet.



I. Historia e Procedures

Me 31 mai 2007 rreth ores 11:30 viktima F saj ne

Arsyetimi

Me aktakuzen PP Nr. 169/2007, te dates 10 shtator 2007, Prokurori Publik i Qarkut ne Mitrovice akuzoi te pandehurin, i cili eshte bashkeshorti i viktimes se ndjere, per veprat penale te Vrasjes se rende ne kundersizim te nenit 147 Paragrafit 9 te KPPK-se dhe Mbajtje ne pronesi, ne kontroll, ne posedim ose ne shfrytezim te paautorizuar te armeve ne kundersizim te nenit 328 Paragrafit 2 te KPPK-se. Aktakuza ishte u qellua per vdekje ne shtepine e konfirmuar ma Aktvendimin e Gjykates se Qarkut ne Mitrovice, te dates 20 nentor 2007. Shqyrtimi gjyqesor filloi me 12 shkurt 2008.

Per shkak te zhvendosjes se stafit te Gjykates se Qarkut ne Mitrovice me force nga ndertesa e gjykates ne mars 2008 shqyrtimi gjyqesor ishte nderprere para se te mund te kryhej. Me 17 gusht 2009 Kryeprokurori i EULEX-it ia caktoi kete lende Prokurorit te Qarkut te EULEX-it ne Mitrovice. Pas kerkeses se Prokurorit te Qarkut te EULEX-it, me 14 tetor 2009 Kryetajja e Asamblese se Gjyqtareve te EULEX-it vendosi qe kete lende ta marrin Gjyqtaret e EULEX-it.

Shqyrtimi gjyqesor para trupit gjykues prej tre (3) Gjyqtareve te EULEX-it te Gjykates se Qarkut ne Mitrovice u mbajt ne mes 21 janarit dhe 16 shkurtit 2010. Me 16 shkurt, me aktgjykimin P. Nr. 215/2007, gjykata shpalli te pandehurin fajtor per vepra penale te (A) Vrasjes se rende ne kundersizim te nenit 147 Paragrafit 9 te KPPK-se dhe (B) Mbajtje ne pronesi, ne kontroll, ne posedim ose ne shfrytezim te paautorizuar te armeve ne kundersizim te nenit 328 Paragrafit 2 te KPPK-se, dhe e denoi te pandehurin me katermbedhjete (14) vjet burgim per piken (A) dhe me dy (2) vjet burgim per piken (B), qe rezulton me nje demin unik me pesembedhjete (15) vjet burgim.

Aktgjykimi iu eshte dorezuar paleve ne mes datave 20 prill dhe 28 prill 2010. Avokati mbrojtës R [REDACTED] K [REDACTED] e pranoi ate me 27 prill 2010 dhe i pandehuri me 28 prill 2010.

Me 29 prill 2010 avokati mbrojtës R [REDACTED] K [REDACTED] paraqiti ankese ne emer te te pandehurit kunder aktgjykimit P Nr. 215/2007.

II. (^eshtjet e ngritura ne ankese:



Avokati mbrojtës R [REDACTED] K [REDACTED] pretendon në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe

gjykata e shkalles se pare ka tejkeluar aktakuzen duke i shtuar Qalet "... per ta ndaluar gruan e tij qe te largohet ..." dhe duke e bere kete ka shkelur nenin 386 paragrafin 1 te Kodit te Procedures Penale te Kosoves (KPPK);

denimit.

Ne ve9anti avokati mbrojtes R [REDACTED] K [REDACTED] pretendon se:

gjykata e shkalles se pare gabimisht ka vertetuar se i akuzuari ka qene xheloz per nje kohe te gjate dhe gabimisht ka perfunduar se kjo xhelozia kishte qene motivi per bete krim;

i akuzuari, kur qelloi bashkeshorten e tij, reagoi ndaj nje fyeije te rende. Viktima e ndjere, e cila kurre nuk e kishte ofenduar ose fyer te akuzuarin me pare, ne dite kritike papritmas e ofendoi ate me keto Qale: "Une nuk kam nevoje te kerkoj Iqe Ti je i vjeter, i lodhur. Askush nuk te pyet per asgje, sepse je i lodhur dhe je i vdekur edhe pse ende je gjalle". Ne kete ?ast i akuzuari e humbi kontrollin dhe e vrau bashkeshorten e tij. Nje fyeije e tille pas 30 viteve jetese bashke eshte e rende, ne ve?anti ne rrethinen rurale ku ata jetonin. Prandaj i akuzuari reagoi ne nje gjendje shoku apo 5rregullimi mendor si? pershkruhet me nenin 148 te Kodit Penal te Kosoves (KPK).

Duke u bazuar ne keto arsye, avokati mbrojtes R [REDACTED] K [REDACTED] propozon te pranohet ankesa, te ndryshohet aktgjykimi i shkalles se pare dhe i akuzuari te shpallet fajtor per vrasje te kryer ne gjendje te afektit mendor ne perputhje me nenin 148 te KPK-se, ose te prishet aktgjykimi i shkalles se pare dhe lenda te kthehet per rigjykim.

Zyra e Prokurorit te Shtetit (ZPSHK) me opinionin e dates 16 gusht 2010, propozon te refuzohet ankesa si e pabazuar dhe te vertetohet aktgjykimi i shkalles se pare. ZPSHK-ja eshte e mendimit se gjykata e shkalles se pare qendroi me "vepren" qe eshte objekt i akuzes te perfshire ne aktakuze dhe prandaj nuk ka tejkeluar aktakuzen. Sa i perket afektit mendor te pretenduar ZPSHK-ja i referohet vleresimit te plote ne aktgjykimin e shkalles se pare. Perve? kesaj ZPSHK-ja eshte e mendimit se i akuzuari nuk ishte ne gjendje te ofroje asnje deshmi lidhur me ofendimin e pretenduar dhe se madje nese i akuzuari do te mund te deshmonte ate provokim nuk do ta ndryshonte cilesimin e kesaj vepre sepse ai e kishte iniciuar kete fyeije te pretenduar me sjelljet e tij. ZPSHK-ja perve? kesaj paraqet se faktet ishin vertetuar drqt dhe sakte nga gjykata e shkalles se pare dhe se vendimi mbi denimin eshte ne pajtueshmeri te plote me nenin 64 te KPK-se.



III. Gjetjet e Gjykates Supreme

Ankesa eshte paraqitur me kohe dhe eshte e pranueshme.

Ankesa, megjithate, nuk eshte e bazuar.

Sa i perket feshetjeve te adresuara ne ankesa Gjykata Supreme e Kosoves konstaton se ne aktgjykimin e shkalles se pare nuk mund te gjenden shkelje te ligjit.

1.

Gjykata e shkalles se pare nuk ka tejkualuar aktakuzen duke i shkruar fjalet "per te ndaluar ate qe te largohet" ne dispozitiv. Sipas nenit 386 paragrafit 1 te KPPK-se aktgjykimi mund t'i referohet vetem me te akuzuarin dhe vetem

vepres qe eshte objekt i akuzes te perfshire ne aktakuze

fjala "veper" ne kete kontekst i referohet ngjajtes ne nje kuptim me te gjere, p.sh. nje pershkrimi te pergjithshem te veprimit te te pandehurit. Kjo nuk mund te interpretohet si nje obligim per te permendur secilin detaj ne aktakuze. Interpretimi i tille nuk gjen asnje mbeshtetje ne ijaleformimin e ligjit dhe perve? kesaj do ta kufizonte trupin gjykues ne nje qasje shume te ngushte gjate gjykimit te kesaj lende qe do te ishte ne kundershtrim me obligimet e gjykates "per te vertetuar ne menyre te sinqerte dhe te plote faktet te cilat jane te rendesishme ne marijen e vendimit te ligjshem", nje element i fuqishem inkuizicioni i percaktuar ne dispozita te ndryshme si? jane neni 7 dhe neni 360 paragrafi 5 i KPPK-se.

Prandaj ne kete lende termi "veper" ne nenin 386 paragrafin te KPPK-se duhet te kuptohet si reference ne komizen e ngjarjes qe i pandehuri qelloi gruan e tij nen rrethanat qe mund te lejojne cilesimin e kesaj vrasjeje si vrasje te rende sipas nenit 147 pika 9 e KPK-se. Gjykata e shkalles se pare qendroi prane ketij pershkrimi te vepres dhe si pasoje e kesaj nuk tejkaloj aktakuzen.

2.

Sa i perket zbatimit te dispozitave te ligjit penal gjykata e shkalles se pare cilesoi drejt krimin e kryer nga i akuzuari si vrasje te rende e jo si vrasje te kryer ne gjendje te afektit mendor (Neni 148 i KPK-se).

Si? ka theksuar Gjykata Supreme e Kosoves ne vendimet e meparshme¹, aplikimi i nenit 148 te KPK-se nuk mund te mohohet vetem per shkak se i akuzuari nuk ka ofruar asnje deshmi per fyeijen e pretenduar nga viktimat e ndjere para vrasjes. Kerkesa e tille per paraqitjen e deshmive eshte ne konflikt me parimin *in dubio pro reo* dhe *supozimin e pafajesise* dhe prandaj do te perbente shkelje te te drejtave themelore individuale te percaktuara me Konventen Evropiane per te Drejtat e Njeriut.

Lidhur me kete Gjykata Supreme e Kosoves ne aktgjykimin e dates 3 gusht 2010, (AP - Kz. No. 128/2010), ka theksuar si ne vijim:

Pasi qe i akuzuari ka dhene nje sqarim te qarte, te detajuar dhe te besueshem per krimin, Gjykata e shkalles se pare ka qene e obliguar nga parimet e supozimit te pafajesise dhe in dubio pro reo si te drejtat me fundamentale te te pandehurit te percaktuara me nenin 6 te Konventes Evropiane per te Drejtat e Njeriut qe te percaktoje nese faktet perkatese duhet te vertetohen apo hedhen poshte ne baze te provave te cilat

deshmujne se tregimi i te akuzuarit eshte ipavertete. Keto parime, te cilat sigurojne qe te drejtat e te pandehurit jane respektuar plotesisht gjate gjykimeve penale, kerkojne qe Gjykata te jet'e e bindur pa asnje dyshim se i pandehuri e ka kryer krimin. Qaredo dyshimi lidhur me kete duhet te respektohet dhe te merret parasysh ne dobi te pandehurit.

Ne baze te ketyre arsyeve, ne lende sikur kjo, ku i akuzuari pretendon ne vetembrojtjen e domosdoshme ose arsye te tjera te cilat mund ta zvogelojne pergjegjesine e tij ose saj penale, nuk eshte e mjaftueshme te koncentrohemi vetem nefaktin se i akuzuari pa asnje dyshim e ka privuar viktimen nga jeta. Kjo ne vetvete nuk eshte e mjaftueshme per ta vertetuar fajin individual personal te te akuzuarit Ligji ofron nje mori te dispozitave ligjore te cilat mundesojne nivele te ndryshme te cilesimit te aktit te vrasjes se nje personi tjetër. Kjo fushe ndryshon nga vrasja e rende si alternativa me e rende e deri ne madje te mos qenit akt kriminal si alternativa me e favorshme, dhe rrjedhimisht ligji parasheh nivele te ndryshme te specifikuara ne menyre eksplicite tefajit personal - vrasje e rende, vrasje, vrasje e kryer ne gjendje te afektit mendor -e madje edhe opsione te cilat e perjashtojne fajin e kryeresit dhe ndalojne shqiptirmin e denimit - vetembrojtja e domosdoshme ose nevoja ekstreme. Parimet e supozimit te pafajesise dhe in dubio pro reo kerkojne percaktimin pa asnje dyshim te nivelit preciz tefajit personal te te pandehurit.

Prandaj, fusha e shqyrtimit nga Gjykata penale e cila i eshte referuar vetem aktit te vrasjes nuk do t'i permbushte kushtet per nje percaktim te plote dhe korrekt te fakteve pasi qe nuk do te mundesonte percaktimin e cilesimit te

¹ Aktgjykimi i datës 3 gusht 2010 (AP – Kž. Nr. 128/2010); shih gjithashtu aktgjykimin e datës 11 dhjetor 2009 (AP – Kž. Nr. 23/2009)



duhur te aktit e qe eshte parakusht i domosdoshem per percaktimin korrekt te fajit personal, dhe si rrjedhoje te denimin e duhur te te pandehurit.

Parimi i supozimit te pafajesise kerkon qe Gjykata tejete e bindur pa asnje dyshim se alternativat te cilat do te rezultonin ne lirimin e te pandehurit mund te perjashtohen. Qartazi, kjo nuk kerkon qe Gjykata sipas detyres zyrtare te marr ne konsiderate te gjitha alternativat teorikisht te mundshme. Ne nje suate, sidoqofte, ku i pandehuri ne mbrojtjen e tij ose saj jep nje tregim te ngjarjeve, Gjykata eshte e obliguar qe te vleresoje kete tregim me kujdesin e duhur dhe respekt te plote per parimin e supozimit te pafajesise. Si pasoje, Gjykata-duhet te vleresoje nese pershkrimi i ngjarjeve nga i pandehuri eshte i besueshem dhe arsyeshem dhe, nese po, a ka deshmi te cilat mundesojne perfundimin pa asnje dyshim qe versioni i dorezuar nga i pandehuri nuk eshte i vertete. Perndryshe, barra e proves do te kalonte te i pandehuri i cili do te duhej te deshmonte pafajesine e tij ose saj².

Ngjashem, ne pajtim me parimin in dubio pro reo, Gjykata eshte e obliguar qe te vleresoje me kujdes nese tregimi i dhene nga i pandehuri mundeson aplikimin e dispozites se ligjit penal i cili do te rezultonte ne nje denim me te bute. Si rrjedhoje Gjykata duhet perseri te vleresoje nese pershkrimi i ngjarjeve nga i pandehuri eshte i besueshem dhe arsyeshem dhe, nese po, a ka deshmi te cilat mundesojne perfundimin pa asnje dyshim qe versioni i dorezuar nga i pandehuri nuk eshte i vertete. Vetem kjo qasje garanton respektimin e plote te parimit in dubio pro reo.

Ne permbledhje, kerkohet nje vleresim i pergjithshem i fakteve te paraqitura, te cilat mund te jene ligjerisht relevanten ne teresine e tyre, qe te percaktohet ne menyre korrekte dhe precize fajesia e mundshme dhe denimi i duhur i te pandehurit.

Kolegji i Gjykates Supreme pajtohet plotesisht me, dhe i permbahet ketyre parimeve. Prandaj, tregimi i dhene nga i akuzuari nuk mund te hedhet poshte per arsyen e vetme qe ai ka deshtuar ne paraqitjen e ndonje deshmie. Pershkrimi i tij i ngjajes eshte i besueshem dhe nuk mund te gjendet asnje deshmi me ane te te ciles kjo pjese e deklarates se tij do te mundte hedhet poshte.

Kjo, sidoqofte, nuk e ndryshon cilesimin juridik. Madje as tregimi i dhene nga vete i akuzuari nuk mundeson aplikimin e nenit 148 te KPK-se.



Gjykata Supreme e Kosoves, aktgjykimi i dates 11 dhjetor 2009, PKL.-Kzz. Nr. 23/2009; e e tjera shprehin shtetet te Evropes - per Mbreterine e Bashkuar, per shembull, shih [uk/legal/s to u/self defence/](http://uk/legal/s%20u/self%20defence/); per ndalimin ne pergjithesi te kalimit te barres tari shih aktgjykimet e Gjykates Evropiane per te Drejtat e Njeriut ne lenden e (rise dhe Murray kunder Mbreterise se Bashkuar

Nuk eshte e domosdoshme te vertetohet nese fjalet e viktimes kane perbere nje "fyeije te rende" dhe nese i akuzuari eshte sjelle ne gjendje te afektit mendor nga ato Qale, sepse aplikimi i nenit 148 te KPK-se kerkon qe e tere kjo te ndodhe "pa fajin e vete atij ose asaj", p.sh. te te akuzuarit. Lidhur me kete, faktet e vertetuara ne menyre korrekte ne aktgjykimin e shkalles se pare nuk lene hapshire per dyshime se viktimat ka reaguar ndaj akuzave te gabuara, fyeijet personale dhe madje keqtrajtimeve fizike te shkaktuara ndaj saj nga i akuzuari para vete ngjajjes. Ishte i akuzuari ai i cili per nje kohe te gjate para ngjajjes e ka ngarkuar dhe ofenduar ate, dyshimet e tij te forta, megjithese te pabaza lidhur me nje afere jashtemartesor, ishte ai i cili e kishte detyruar ate qe t'i nenshtrohet - poshterimit - fyeijes, ishte ai i cili nuk e lejonte ate te largohet nga shtepia pa percjellje nga ai ose nga njeri nga femijet e tyre, dhe ishte ai i cili e kishte keqtrajtuar fizikisht dhe cenuar seksualisht si? eshte cekur ne aktgjykimin e shkalles se pare.

Si pasoje, nuk ekziston asnje dyshim se gjate gjithë kohes ishte faji i tij i cili e detyroje viktimen te reagoje ne ditën kritike ne menyren e pershkruar nga i akuzuari. Duke vepruar ne ate menyre, ajo vetem ka reaguar ndaj kembenguljes se tij ofenduese qe ajo duhej te merrte leje nga ai para se te largohej nga shtepia. Kjo e peijashton aplikimin e nenit 148 te KPK-se

3.


Gjykata e shkalles se pare ka aplikuar ne menyre te drejte piken 9 te nenit 147 te KPPK- se. I akuzuari e ka privuar bashkeshorten e tij nga j eta per shkak te motiveve te uleta.

Motivet e uleta jane te gjitha ato motive te cilat nuk vlejne sa nje qenie njerezore dhe te cilat nuk perkojne me vlerat e pranuar morale te shoqerise, ato jane pika me e ulet e nivelit te vlerave sipas gjykimit moral³.

Mund te kontestohet nese xhelozia ne vetvete mund te shihet si motiv i ulet⁴. Ne lenden ne Qale, i akuzuari nuk ka vepruar vetem nga xhelozia. Ai gjithashtu e vrau bashkeshorten e tij per shkak se ajo morri "guximin" te largohet nga shtepia pa lejen e tij. Pavaresisht nese ajo ka dashur te largohet nga shtepia perkohesisht apo pergjithmone, p.sh. ndajja nga ai, reagimi i tij ndaj ketij tentimi - duke e qelluar - demonstroi besimin e tij qe ai ka pasur te drejte te vendose mbi te drejten e saj per te jetuar. Ky koncept i pameshirshem egoist i te qenit sovran mbi ekzistencen tregon mosrespektimin me te thelle per te drejten natyrore te nje qenies tjeter njerezore per te jetuar, dhe si i tille eshte nje motiv i ulet.

³ Shih SRZENTIC, Nikola - STAJIC, dr. Aleksandar - KRAUS dr. Bozidar - LAZAREVIC, dr. Ljubisa - DJORDJEVIC, dr. Miroslav, Komentari MBI LIGJET PENALE TE RS SERBISE, KSA TE KOSOVES DHE KSA TE VOJVODINES, 1981, "ADMINISTRATA BASHKEKOHORE" BEOGRAD, Komentari mbi Kodin Penal te Serbise, Neni 47 Nr. 7 pika d;

⁴ Gjykata Supreme e Serbise ne aktvendimin e saj Kz-2105/57 nuk e ka cilesuar xhelozine si motiv te ulet; gjithashtu Gjykata Supreme e Kroacise ne aktvendimin e saj Kz-2333/56 ka theksuar qe



xhelozia nuk perfaqeson nje motiv te ulet.

Pasi qe, neni 147 i KPK-se percakton nje denim prej se paku dhjete (10) vjet burgim ose burgim afatgjate, denimi i shqiptuar nga gjykata e shkalles se pare ndaj te akuzuarit per kete veper penale eshte vetem pak mbi denimin minimal dhe, sidoqofte jo shume i larte.

Si rezultat, <eshtjet e adresuara ne ankese - i referohen vetem denimit per Vrasje dhe jo vepres penale Mbajtja ne pronesi, ne kontroll, ne posedim ose ne shfrytezim te paautorizuar te armeve - nuk lejojne pranimin e ankeses.

Perve? kesaj, kolegji i Gjykates Supreme ka vleresuar ne teresi ?eshtjet te cilat duhet te ekzaminohen sipas detyres zyrtare (shih nenin 415 te KPPK-se). Nuk jane gjetur shkelje te rregullave dhe 9eshtjeve perkatese.

Prandaj, ankesa eshte refuzuar si e pabazuar dhe aktgjykimi i shkalles se pare eshte vertetuar.

GJYKATA SUPREME E KOSOVES NE PRISHTINE AP-Kz.

Nr. 192/2010

Kryetari i kolegjit

Norbert Koster Gjyqtar
i EULEX-it

Anetare e kolegjit

Anetar i kolegjit

Martti Harsia
Gjyqtar i EULEX-it

Anetare e kolegjit

Nesrine Lushta
Gjyqtare e
Gjykates

Supreme

Marije Ademi
Kosoveli
me
h
..

SAKTESINE E KOPJES E VERTETON
NOSTI OTPRAVKA POTVRDJUJE

Anetar i kolegjit
Punetori i autorizuar
Ortakseni rednik

Salih Toplica
Gjyqtar i Gjykates Supreme

